

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

**11.07.2024
Ora 12:07**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulës së Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, Komisionit të Qendrës së Votimit, vulës së kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit, të KZAZ-së nr. 88, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Stafi KQZ: Znj. D. Alimemeti, znj. P. Doçaj, z. E. Meta.**
- **Parti Politike: PD (z. F. Nuri)**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë në seancën e sotme publike kemi në rend të ditës:

- Projektvendimin “Për miratimin e formatit dhe specifikimeve të vulave të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe vulës së kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit të KZAZ nr. 88, për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Himarë, të Qarkut Vlorë, të datës 4 gusht 2024.”
- Projektvendimin “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, për këto zgjedhje.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

- Kemi projektvendimin që lidhet me “Verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues zotit Tonin Marinaj, kryetar i Bashkisë Malësi e Madhe” dhe,

- projektvendimet që lidhen me “Plotësimin e disa vakancave në Këshillin e Bashkisë Pogradec, Roskovec, Devoll dhe Lezhë”.

Mirë, atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Shumë shkurt me projektvendimin për formatin e vulave.

Znj. D. Alimemeti: Përshëndetje, referuar përcaktimeve të nenit 99, të ligjit 1019, Kodit Zgjedhor, KQZ kërkon që Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor, materialet zgjedhore që përdoren për administrimin e procesit dhe materialet zgjedhore për Komisionet e Qendrave të Votimit të kalojnë, ose le të themi të miratohen. Neni 103, pika 2, përcakton tekstin që duhet të mbajnë vulat e Komisionit të Qendrës së Votimit me numrin e qendrës përkatëse. Vulat...

Z. I. Celibashi: Jua kemi përcjellë partive, këtë, ne?

Znj. D. Alimemeti: Po.

Z. I. Celibashi: Nuk kemi pasur ndonjë gjë, se ky vendim teknik është?!

Znj. D. Alimemeti: Jo.

Z. I. Celibashi: Kemi përfaqësuesin e Partisë Demokratike, kemi ndonjë gjë në lidhje me këtë?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD-së: Faleminderit zoti Celibashi! Jo, nuk kemi asnjë lloj vërejtje në lidhje me pjesën e materialit, po themi, zgjedhor, vulën në rastin konkret apo qoftë dhe për shortin. Ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, që të mos harxhojmë kohën për këtë gjë. Mirë, atëherë miratojmë projektvendimin sipas draftit të paraqitur dhe modeleve që janë propozuar nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 73

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

**11.07.2024
Ora 12:10**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 88, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :


KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, znj. P. Doçaj, z. E. Meta.
- Parti Politike:** PD (z. F. Nuri)
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, që ka të bëjë me “Caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së nr. 88 për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë.” Po, Erioni, drejtori.

Z. E. Meta: Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 244, datë 05.07.2024, ka caktuar datën e zgjedhjeve 04.08.2024, për Kryetarin e Bashkisë Himarë. Referuar nenit 19, shkronja “ç”, të ligjit të Kodit Zgjedhor, si dhe nenit 7, të rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonave të Administrimit Zgjedhor, miratuar me vendim të Komisionit Rregullator, përcaktohet kompetenca e Komisionerit për të emëruar anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-së. Kodi Zgjedhor, në nenin 29, pika 1, përcakton se anëtarët e KZAZ-së emërohen nga KQZ sipas kësaj procedure:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

“Dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e shumicës parlamentare, dy anëtarë propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare, një anëtar propozohet nga partia e dytë e shumicës parlamentare dhe një anëtar propozohet nga partia e dytë e opozitës parlamentare.” Në rast se nuk arrihet baraspeshimi politik, grupi përkatës kompenson nga kandidurat e partisë kryesore deri në baraspeshimin politik, shumicë-opozitë. Anëtari i shtatë propozohet në gjysmën e KZAZ-ve nga partia e parë e shumicës parlamentare, kurse në gjysmën tjetër, nga partia e parë e opozitës parlamentare. Bazuar në përcaktimet e nenit 29, pika 4 e Kodit Zgjedhor, në zgjedhjet vendore, renditja përcaktohet mbi bazën e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë, në zgjedhjet pararendëse nga partitë parlamentare. Mbështetur në vendimin 27, datë 07.08.2023, të Komisionit Rregullator për shpalljen e rezultatit përfundimtar për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, bazuar në rezultatet e numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë, subjektet zgjedhore janë renditur si vijon:

Partia Socialiste e Shqipërisë me 43% të votave;

“Bashkë Fitojmë” me 18.40% të votive;

Partia Demokratike me 7.71% të votive;

Partia Socialdemokrate me 6.42% të votave.

Referuar shkresës së Kuvendit të Shqipërisë, të datës 24.01.2022, me numër protokolli 259/1, partitë parlamentare janë si vijon: shumica parlamentare është Partia Socialiste e Shqipërisë, me 74 mandate dhe pakicë parlamentare janë, Partia Demokratike e Shqipërisë (Aleanca për Ndryshim) me 59 mandate, Lëvizja Socialiste për Integrim me 4 mandate, Partia Socialdemokrate me 3 mandate.

Në analizë të dispozitave të Kodit Zgjedhor, rezultati përfundimtar i zgjedhur për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 dhe të shkresës së Kuvendit të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

Shqipërisë, arsyetohet si vijon: neni 29, pika 4, fjalia e dytë e Kodit Zgjedhor, përcakton qartë procedurën që ndiqet për caktimin e partive që kanë të drejtën të propozojnë anëtarët e KZAZ-së. Në zgjedhjet vendore renditja përcaktohet në bazë të numrit të votave të fituara në shkallë vendi për këshillat vendorë, në zgjedhjet pararendëse, nga partitë parlamentare. Që një parti të gëzojë të drejtën për të propozuar kandidat për KZAZ-në, duhet të plotësojë dy kushte: së pari të ketë marrë pjesë në zgjedhjet pararendëse për organet e pushtetit vendor dhe së dyti, të jetë parti parlamentare. Dy anëtarë të KZAZ-së propozohen nga partia kryesore e shumicës që ka fituar më shumë vota për këshillat vendorë në datë 14 maj 2023 dhe një anëtar nga partia e dytë e shumicës parlamentare. Dy anëtarë të KZAZ-së propozohen nga partia kryesore e opozitës parlamentare që ka fituar më shumë vota për këshillat vendorë në 14 maj 2023 dhe një anëtar nga partia e dytë e opozitës parlamentare. Anëtari i shtatë në zgjedhjet për kryetarin e Bashkisë Himarë do të përcaktohet me short, ndërmjet këtyre partive. Projektvendimi që është paraqitur për miratim, bazohet në vendimin nr. 35, datë 15.09.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor të vendimarrjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për caktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarin dhe sekretarin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, nr. 11, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, arritën në përfundimin se: partia kryesore e opozitës parlamentare është Partia Demokratike e Shqipërisë, ndërsa partia e dytë e opozitës parlamentare është Partia e Lirisë. Duke qenë se jemi në kushte dhe rrethana juridike të njëjta, për sa më lart, renditja e partive për efekt të zbatimit të procedurës për përbërjen e KZAZ-së nr. 88, për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Himarë, është si më poshtë, vijon:

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

Partia Socialiste e Shqipërisë do të propozojë tre kandidatura për anëtarë të KZAZ-së, dy kandidatura si parti e parë e shumicës parlamentare dhe kandidatura e tretë për të realizuar baraspeshimin politik shumicë-opozitë, në përbërjen e KZAZ-së.


Partia e parë e opozitës parlamentare që do të propozojë dy anëtarë të KZAZ-së është Partia Demokratike e Shqipërisë dhe partia e dytë e opozitës parlamentare, e cila do të propozojë një anëtar të KZAZ-së është Partia e Lirisë.

Shorti do të ndjekë hapat e përcaktuar në nenin 4, të vendimit 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator, për miratimin e rregullores.

Z. I. Celibashi: Shorti për anëtarin e shtatë.

Z. E. Meta: .. për anëtarin e shtatë. Emrat e partive pjesëmarrëse në short, shkruhen në një shirit letre, të cilat mbyllen në dy gogla, me formë, peshë, ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë transparente. Dy shirita letre, ku në shiritin e parë shkruhen KZAZ-të e numrave tek dhe në shiritin tjetër KZAZ-të çift, mbyllen në dy gogla, me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë dhe vendosen në një enë të dytë transparente. Një nëpunës i administratës tërheq njëri nga goglat që ndodhen në enën e parë. Përfaqësuesi i partisë politike, emri i të cilit ndodhet në shiritin e letrës, brenda goglës së tërhequr nga ena e parë, tërheq i pari njëri nga goglat në enën e dytë. Në mungesë të përfaqësuesit të partisë politike përkatëse, Komisioneri mund të caktojë një nëpunës të administratës. Partisë politike, përfaqësuesi i së cilës, tërheq goglën në enën e dytë, i lind e drejta të propozojë anëtarin e KZAZ-së, sipas përcaktimit në shiritin e letrës që ndodhet brenda goglës së tërhequr. Duke qenë se në zgjedhjet e datës 4 gusht 2024, zhvillohen vetëm në KZAZ-në 88, Bashkia Himarë, partisë politike, përfaqësuesi i së cilës tërheq gogla, në enën e dytë, në përcaktimin, shirit çift, ka të drejtën të propozojë anëtarin e shtatë të kësaj KZAZ-je. Në përfundim të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

shortit, ndërmjet Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike, për përcaktimin e anëtarit të shtatë, do të përcaktohet dhe partia e cila ka të drejtë të propozojë sekretarin e KZAZ-së nr. 88. Përpara se të vijohet me shortin.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Paraprakisht, vetëm përfaqësuesin e Partisë Demokratike kemi në seancë. Para se të fillojmë me procedurën e shortit besoj jemi dakord deri këtu. Pra, tre anëtarë propozohen nga Partia Socialiste e Shqipërisë, dy anëtarë propozohen nga Partia Demokratike, një anëtar i KZAZ-së propozohet nga Partia e Lirisë. Anëtarin e shtatë do ta përcaktojmë nga shorti, dakord?

Z. F. Nuri: Po, dakord, i nderuar!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Mirë, atëherë fillojmë me procedurën e shortit për të përzgjedhur partinë që do të ketë të drejtën për të propozuar anëtarin e shtatë. Bëjmë një demonstrim të atyre shiritave të letrës që do të vendosen nëpër gogla. Meqenëse përfaqësuesi i Partisë Demokratike është këtu për tërheqjen e shortit!

Z. F. Nuri: Faleminderit zoti Celibashi! Unë do t'ia lë ta hedhi shortin KQZ-ja, administrata e KQZ-së. I besojmë KQZ-së për hedhjen e këtij shorti. Pa merak fare. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Edhe për të tjerat! Duhet ta pranoni!

Z. F. Nuri: Për shortin, për procedurën, siç e thashë po ia lë, edhe për supersticion, po ia lë KQZ-së, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

Z. I. Celibashi: Faleminderit juve! Po, Sara!

Partia Demokratike e Shqipërisë ka të drejtën të tërheqë gogllën, për të kuptuar të tjerët. Po, atëherë dhe anëtari i shtatë i KZAZ-së i takon e drejta e propozimit Partisë Demokratike.

Mirë, faleminderit Sara.


Atëherë, në përfundim, kemi ndonjë gjë për procedurën? Përfaqësuesi i Partisë Demokratike, dakord?

Z. F. Nuri: Dakord.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë, në përfundim edhe të procedurës së shortit, përfundimisht Komisioni Zonal i Administrimit të Zgjedhjeve të pjeshme për kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024 do të përbëhet nga tre anëtarë të propozuar nga Partia Socialiste, tre anëtarë të propozuar nga Partia Demokratike dhe një anëtar i propozuar nga Partia Lëvizja e Lirisë, sekretari do të propozohet nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Mirë, faleminderit!

Vendimi nr. 79

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues zotit Tonin Zef Marinaj, Kryetar Bashkie në Bashkinë Malësi e Madhe, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :


KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, znj. P. Doçaj, z. E. Meta.
- Parti Politike:** PD (z. F. Nuri)
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pikat e tjera të rendit të ditës. Po, Pavlina.

Znj. P. Doçaj: Pika e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues të zotit Tonin Zef Marinaj, kryetar i Bashkisë, në Bashkinë Malësi e Madhe, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë. Zoti Tonin Zef Marinaj është propozuar nga ky subjekt, pra nga Partia Socialiste e Shqipërisë, si kandidat për kryetar për Bashkinë e Malësisë së Madhe, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Për këtë kandidat është depozituar në datën 02.04.2023 formulari i dekriminalizimit, nga verifikimi i të dhënave në këtë formular vetëdeklarimi, zoti Tonin Zef Marinaj rezulton se nuk ka të deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

parashikimet për ndalime në ligjin 138/2015. Në kuadër të verifikimeve paraprake dhe të kushteve të kandidatit, sipas këtij ligji, për garantimin e integritetit personal, të personave që zgjidhen ose që ushtrojnë funksione publike, KQZ ka kryer verifikime të mëtejshme, ka kërkuar informacion në strukturat e gjendjes gjyqësore dhe në Zyrën e Gjendjes Civile, nga ku ka rezultuar se për këtë kandidat nuk ka vendime penale të formës së prerë dhe nuk ka ndryshime në gjeneralitete. Për këtë arsye, në datën 25.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 618 i ka dhënë mandatin e Kryetarit të Bashkisë, për Bashkinë e Malësisë së Madhe.

Nga grupi parlamentar i Partisë Demokratike kemi një shkresë, më saktë i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, në datën 28.06.2024, për kryerjen e verifikimit të thelluar të formularit të dekriminalizimit për zotin Tonin Marinaj. Prokuroria e Përgjithshme me datë 03.07.2024 ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën e këtij grupi parlamentar, ku kërkohet verifikim në formularin e vetëdeklarimit dhe të dhënat e deklaruara në këtë të fundit nga zoti Tonin Marinaj. Në kuadër kjo, të disa hetimeve të kryer nga Gjykata e Shkallës së Parë të Firences në Itali, për të cilat pretendohet se ky i fundit nuk i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. Nga këto konstatime dhe në referim të ligjit 138/2015 dhe të vendimit të Kuvendit nr.17/2016, ne propozojmë që verifikimi të kryhet nga Prokuroria e Përgjithshme, pasi është organi kompetent, i caktuar me ligj, bashkëlidhur edhe projektvendimi përkatës.

Z. I. Celibashi: Po. Kemi ndonjë diskutim nga përfaqësuesit e partive politike? Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

Z. F. Nuri: Jo, jo ndonjë gjë specifike, thjesht, që ne kërkojmë zbatimin e ligjit dhe sikundër ligji e parashikon që në këto raste janë organet e përcaktuara, Prokuroria e Përgjithshme që të kryejë verifikimet përkatëse, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit. Atëherë, për sa u relatua do të vendosim që:

- Të dërgojmë të dhënat për verifikim të mëtejshëm, për vlerësim të mëtejshëm, pranë organit të Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin vetëdeklarues zotin Tonin Marinaj, Kryetar i Bashkisë, Malësi e Madhe, propozuar nga subjekti zgjedhor, Partia Socialiste e Shqipërisë.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve dhe,
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.

Vendimi nr. 76

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

**Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pogradec,
Roskovec, Devoll dhe Lezhë”.**

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. D. Alimemeti, znj. P. Doçaj, z. E. Meta.
- Parti Politike:** PD (z. F. Nuri)
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Po, vazhdojmë me plotësimet e vakancave në këshillat bashkiakë.

Znj. P. Doçaj: Po, Bashkia Pogradec, Roskovec, Devoll dhe Lezhë, i ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, një njoftim për krijimin e vakancave në këshillat përkatës së këtyre bashkive. Referuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, është vijuar me verifikimin e listës shumemërore të kandidatit pasardhës, të subjekteve zgjedhore në këshillat bashkiakë përkatës. Kandidatët kanë depozituar brenda afateve ligjore formularët e dekriminalizimit, është kryer verifikimi përkatës i të dhënave të deklaruara në to. Më pas është proceduar me kërkimin e informacionit pranë Zyrës së Gjendjes Civile dhe asaj Gjyqësore, nga ku ka rezultuar që të gjithë kandidatët, nuk kanë dënime penale të formës së prerë dhe nuk kanë ndryshime në gjeneralitete. Në mbështetje të ligjit dhe të vendimit të Kuvendit, të dhënat e deklaruara në formularët e dekriminalizimit nuk përbëjnë kusht për

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.11.07.2024*

moszgjedhshmërinë e tyre në funksionet e këshillëtarit për këshillit bashkiakë: Pogradec, Roskovec, Devoll dhe Lezhë. Projektvendimet përkatëse janë bashkëlidhur.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit. Atëherë,

- Plotësojmë vakancën në Këshillin e Bashkisë Pogradec me kandidatin nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zonjën Sara Olldashi.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Roskovec, me kandidatin nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zonjën Aleksandra Lamaj.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, me kandidatin nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, zotin Alfred Gjata.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialdemokrate, zoti Ervin Coli.

Po, çështje të tjera nuk kemi në rend dite. Mirë, faleminderit! Seanca mbyllet dhe ditë të mbarë!

Vendimi nr. 74, 75, 77, 78.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

